



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**USTAVNI SUD**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 7 tetor 2024  
Nr. Ref.: RK 2546/24

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI223/23**

Parashtrues

**Adem Dauti**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Rev. nr. 106/2023] të 24 majit 2023  
të Gjykatës Supreme,**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare  
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare  
Safet Hoxha, gjyqtar  
Radomir Laban, gjyqtar  
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare  
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar  
Enver Peci, gjyqtar dhe  
Jeton Bytyqi, gjyqtar

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Adem Dauti nga Mitrovica (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [Rev. nr. 106/2023] të 24 majit 2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës [ (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), në ndërlidhje me Aktgjykimin [Ac. nr. 2330/18] të 5 korrikut 2022 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) të 5 korrikut 2022 dhe Aktgjykimin [C. nr. 140/14] të 12 marsit 2018 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) në ndërlidhje me Vendimin (Njoftimin) e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të 24 majit 2011 dhe Aktvendimin [05 nr. 354/86123] e 22 nëntorit 2016 Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të cilat vendime ishin objekt i shqyrtimit në procedurë para gjykatave të rregullta.
3. Parashtruesi i kërkesës pranoi Aktgjykimin e Gjykatës Supreme më 12 qershor 2023.

## **Objekti i çështjes**

4. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve të lartpërmendura të autoriteteve komunale dhe atyre të gjykatave të rregullta, për të cilat parashtruesi i kërkesës specifikon se të njëjtat janë nxjerrë në shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Baza juridike**

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatën Kushtetuese**

6. Më 11 tetor 2023, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), e cila kërkesë u pranua në Gjykatë më 16 tetor 2023.
7. Më 20 tetor 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR. KI223/23] dhe Vendimit [KSH. KI223/23] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 25 tetor 2023, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Po të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore, përmes të cilës kërkoi që ta dorëzojë fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme. Gjykata Themelore nuk i është përgjigjur kësaj kërkesë të Gjykatës.
10. Më 4 mars 2024, Gjykata përsëri i dërgoi një shkresë Gjykatës Themelore, përmes të cilës kërkoi fletëkthesën, e cila dëshmon se kur parashtruesi i kërkesës e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme.

11. Të njëjtën ditë, Gjykata Themelore, përmes postës elektronike, dërgoi dëshminë, përkatësisht fletëkthesën, e cila dëshmon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme, parashtruesit të kërkesës i ishte dorëzuar më 12 qershor 2023.
12. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
13. Më 13 maj 2024, si rezultat i asaj që parashtruesi nuk kishte qartësuar mjaftueshëm kërkesën e tij të dorëzuar, Gjykata i dërgoi një shkresë plotësuese, përmes të cilës i kërkoi që të saktësojë dhe sqarojë se cilin vendim të autoritetit publik e konteston dhe cilat të drejta dhe liri të garantuara me Kushtetutë, atij i janë shkelur me atë vendim.
14. Më 31 maj 2024, parashtruesi i kërkesës dërgoi një përgjigje në Gjykatë, duke specifikuar se në Gjykatën Kushtetuese konteston "*Vendimi[n] (Njoftimi) [e] Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Mitrovicës i datës 24.05.2011, si dhe Aktvendimi [05 nr. 354/86123] i Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës i datës 22.11.2016*".
15. Më 11 shtator 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuesr dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

### **Përmbledhja e fakteve**

16. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i kontestit para organeve të lartpërmendura të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe gjykatave të rregullta ishte çështja e së drejtës së shfrytëzimit të ngastrës nr. 2918/1. Më konkretisht, në vitin 2000, parashtruesi i kërkesës kishte lidhur një kontratë me Ndërmarrjen Shoqërore "*Agrokultura*" për të drejtën e shfrytëzimit të ngastrës nr. 2918/1 për një periudhë gjashtë (6) vjeçare, me mundësi vazhdimi. Gjatë vitit 2014, Kuvendi Komunal i Mitrovicës së Jugut nxori Vendimin mbi ndërrimin e bartësve të së drejtës së shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme shoqërore, në pronë komunale, dhe rrjedhimisht Komuna e Mitrovicës së Jugut, në librat kadastralë është regjistruar si pronare e ngastrës kontestuese nr. 2918/1. Si rezultat i vendimit të lartpërmendur, parashtruesi i kërkesës inicioi procedurë administrative pranë organeve kompetente komunale, përfshirë këtu edhe katër (4) procedura të ndryshme gjyqësore pranë Gjykatës Themelore.
17. Më 10 mars 2014, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut, për shkak të pengimit të shfrytëzimit të pronës dhe për kompensimin e dëmit në shumë prej 84,075.33 euro, me kamatë.
18. Më 25 mars 2014, derisa procedura e parë gjyqësore ishte në procedurë të shqyrtimit, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Drejtoria për Inspeksion e Komunës së Mitrovicës së Jugut përmes Aktvendimit [05. nr. 354/8880] urdhëroi parashtruesin e kërkesës të rrenojë objektin montues të cilin e kishte ndërtuar pa leje në ngastrën në fjalë.
19. Më 20 korrik 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti një kërkesë për shfrytëzim afatgjatë të një pjese të ngastrës kontestuese.
20. Më 21 tetor 2016, Komuna e Mitrovicës së Jugut, Sektori Pronësor-Juridik nxori Aktvendimin [05-464-79098], me të cilin i kërkoi parashtruesit të kërkesës "*të lirojë*

*pronën e paluajtshme të Komunës”.*

21. Më 22 nëntor 2016, Drejtoria për Inspeksion e Komunës së Mitrovicës së Jugut nxori Aktvendimin [05 nr. 354/86123], me të cilin urdhëroi që *“parashtruesi i kërkesës brenda afatit prej 15 ditësh të rrënojë objektin afarist ...”.*
22. Më 24 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës në Drejtorinë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut paraqiti kërkesën për rishqyrtim të aktvendimit, duke kërkuar që *“Aktvendimi i atakuar të ANULOHET në tërësi si joligjor dhe i parregullt dhe të pezullohet procedura administrative ...”.*
23. Më 25 nëntor 2016, parashtruesi i kërkesës kundër Aktvendimit [05 nr. 354/86123] të Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut paraqiti ankesë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (në tekstin e mëtejme: MMPH).
24. Më 22 dhjetor 2016, Drejtoria për Inspeksion-Sektori i Ndërtimit pranë Komunës së Mitrovicës së Jugut nxori Aktvendimin [nr. 05/354-86802], *“me të cilin obligohet pala për lirim të pronës së Komunës”.*
25. Më 23 dhjetor 2016, Drejtoria për Inspeksion e Komunës së Mitrovicës së Jugut nxori Aktvendimin [05-355/93158], me të cilin urdhëroi parashtruesin e kërkesës që të largonte të gjitha materialet e tij nga sipërfaqja publike.
26. Duke pasur parasysh se MMPH nuk iu përgjigj ankesës së parashtruesit të kërkesës të 25 nëntorit 2016, parashtruesi i kërkesës, më 25 dhjetor 2016, parashtrroi kërkesëpadi në Gjykatën Themelore *“për shkak të heshtjes së MMPH-së”.*
27. Më 4 janar 2017, parashtruesi i kërkesës paraqiti një propozim në Gjykatën Themelore, duke kërkuar caktimin e masës së sigurimit kundër të paditurit, përkatësisht Komunës së Mitrovicës së Jugut që të *“ndalohet tjetërsimi, fshehja, ngarkimi apo disponimi me pasurinë në fjalë”.*
28. Më 27 janar 2017, parashtruesi i kërkesës në Gjykatën Themelore paraqiti gjithashtu kërkesëpadi kundër Komunës së Mitrovicës së Jugut, me të cilin kërkoi shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit [nr. 05 NR 354/86123] të Komunës së Mitrovicës së Jugut të 22 nëntorit 2016, derisa gjykata të nxjerrë një aktgjykim meritor për kërkesëpadinë e paditësit lidhur me heshtjen e MMPH-së.
29. Më 16 shkurt 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C. nr. 140/14] refuzoi si të pabazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për caktimin e masës së sigurisë.
30. Më 20 mars 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 153/2017] hodhi poshtë si të palejueshme kërkesën e parashtruesit lidhur me shtyrjen e ekzekutimit të Aktvendimit [nr. 05 NR 354/86123] të Komunës së Mitrovicës së Jugut deri në marrjen e vendimit meritor lidhur me heshtjen e MMPH-së.
31. Më 12 mars 2018, Gjykata Themelore përmes Aktgjykimit [C. nr. 140/2014], sipas padisë së parashtruesit të kërkesës të 10 marsit 2014, lidhur me kompensimin e dëmit në shumë prej 84,075.33 euro, me kamatë, refuzoi si të pabazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës.

32. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj [C. nr. 140/2014], Gjykata Themelore *inter alia* theksoi:
- “Paditësi pretendon se në formë të heshtur e ka vazhduar validitetin apo kohëzgjatjen e kontratës mbi shfrytëzimin në bazë të nenit 596, paragrafi 1 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve citoi: “Kur pasi të ketë kaluar koha për të cilën është lidhur kontrata e qirasë, qiramarrësi vazhdon të përdor sendin, ndërsa qiradhënësi nuk e kundërshton këtë, konsiderohet se është lidhur kontratë e re e qirasë me kohëzgjatje të pacaktuar në të njëjtat kushte sikundër edhe në ato paraprake”. Nëse analizohet me kujdes kjo dispozitë është e mjaftueshme për të kuptuar se në rastin konkret nuk ka fare kontratë të veçantë në mes të paditësit dhe pronarit të ri të tokës. Nuk mund të konsiderohet përtëritje e kontratës nëse vetëm njëra palë në rastin konkret vazhdon ta përdor sendin, ndërsa pala tjetër nuk deklarohej se e kundërshton apo jo, mirëpo qiramarrësi nuk ka prova se ka vazhduar me pagesa të qirasë. Gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ka të drejtë ligjore që pala paditëse të thirret në përtëritje të kontratës apo vazhdim të saj në afat të pacaktuar pasi me pronarin e ri nuk ka kurrfarë raporti kontraktual për qiramarrje”.*
33. Në një datë të paspecifikuar, kundër Aktgjykimit [C. nr. 140/2014] të Gjykatës Themelore, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit, duke pretenduar vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
34. Më 12 dhjetor 2018, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [A. nr. 153/2017] aprovoi si të bazuar kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për shkak të heshtjes së MMPH-së dhe e urdhëroi MMPH që *“në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, të merr aktvendim sipas kërkesës së paditësit të dt. 25.11.2017”.*
35. Më 30 prill 2019, MMPH përmes Vendimit [nr. A-296/16] shfuqizoi Aktvendimin [nr. 05/354-86802] e Drejtorisë për Inspeksion–Sektori i Ndërtimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke kthyer lëndën në rishqyrtim.
36. Më 6 qershor 2019, Drejtoria për Inspeksion–Sektori i Ndërtimit pranë Komunës së Mitrovicës së Jugut nxori Njoftimin [525/2019-2], në të cilin thuhet se *“mbetet në fuqi aktvendimi i datës 22.12.2016 i Drejtorisë për Inspeksion”.*
37. Më 18 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës kundër Njoftimit të lartcekur [525/2019-2] paraqiti ankesë në Drejtorinë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës administrative.
38. Më 20 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës kundër Njoftimit të lartcekur [525/2019-2] të Komunës së Mitrovicës së Jugut parashtrroi ankesë në MMPH.
39. Më 16 tetor 2019, MMPH nxori Vendimin me të cilin aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Njoftimin [nr. 25/2019-2] e Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut të 30 prillit 2019.
40. Më 24 tetor 2019, Drejtoria për Inspeksion e Komunës së Mitrovicës së Jugut përmes Vendimit [ZSP-1239/2019] vendosi që të mbeten në fuqi të gjitha aktet administrative të nxjerra nga Drejtoria për Inspeksion, si dhe institucionet komunale të Komunës së Mitrovicës së Jugut.

41. Më 3 dhjetor 2019, parashtruesi i kërkesës i propozoi MMPH-së, që të japë pëlqimin e saj për vendimin me të cilin detyrohet Komuna e Mitrovicës së Jugut të lidhë kontratë për shfrytëzimin afatgjatë të ngastrës në fjalë.
42. Më 10 janar 2020, MMPH nxori Aktvendimin me të cilin e shpalli të paligjshëm Vendimin [ZSP-1239/2019] e Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës të 24 tetorit 2019.
43. Më 29 janar 2020, parashtruesi i kërkesës i propozoi Komunës së Mitrovicës së Jugut arritjen e një marrëveshjeje të vullnetit të mirë lidhur me kërkesën.
44. Më 5 korrik 2022, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 2330/18] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit [C. nr. 140/2014] të Gjykatës Themelore të 12 marsit 2018.
45. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2330/18] të Gjykatës së Apelit paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, duke pretenduar si mungesë të arsytimit të Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit dhe zbatim të gabuar të “*nenit 596, paragrafi 1 të LMD-së, si dhe faktin se kemi të bëjmë me një vendim të paligjshëm të Komunës sipas Vendimit të MMPH-së*”.
46. Më 24 maj 2023, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev. nr. 106/2023] refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit të kërkesës të parashtruar kundër Aktgjykimit [Ac. nr. 2330/2018] të Gjykatës së Apelit të 5 korrikut 2022.
47. Në arsyetimin e Aktgjykimit të saj, Gjykata Supreme theksoi:

*“[...] paditësi ka qenë i vetëdijshëm se ka lidhur kontratë me afat të caktuar dhe se në kontratë janë pajtuar që i njëjti ka vetëm të drejtën e shfrytëzimit të pronës dhe në asnjë rast të bëjë ndërtime jashtë planit ... .*

*Në raport me pretendimet e paditësit në revizion se sipas nenit 596, paragrafi 1 i LMD-së, kontrata ka vazhduar për faktin se e paditura nuk e ka kundërshtuar të njëjtën, Gjykata Supreme vlerëson se të njëjtat pretendime janë të pabazuara. [...], pasi që kemi ndërrim të pronarit të pronës dhe nuk kemi ndonjë raport kontraktual në mes të pronarit të ri dhe paditësit. Gjithsesi edhe në rast se kontrata do të konsiderohej se është vazhduar, në dispozita të kontratës saktësisht nga nenet e lartcekura, pamë se paditësi nuk i ka pas të lejuara ndërtimet [...]”.*

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

48. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij pretendon se vendimet e autoriteteve komunale dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta, janë nxjerrë në shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] të Kushtetutës.
49. Shkelja e nenit 3 të Kushtetutës, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, konsiston në faktin se “*në procedurën administrative tek organi komunal i Mitrovicës janë vënë në pozitë të pabarabartë si palë dhe si subjekt afarist duke më injoruar në të gjitha shkresat të cilat i kam bërë dhe duke mos i zbatuar asnjë vendim të shkallës së dytë – Gjykatës Administrative e cila ka gjetë se në vendimet e organeve Komunale në dëmin tim janë bërë shkelje drastike ligjore, duke më pamundësuar lidhjen e kontratës mbi shfrytëzimin*

*e ngastrës kadastrale të cilën Komuna e Mitrovicës e ka bartë pa njoftimin tim paraprak dhe duke mos ma mundësuar që të njëjtën ta shfrytëzoj me anë të raportit pronësoro-juridik dhe për mundësinë e shfrytëzimit të saj konform veprimtarisë së ndërmarrjes ndërtimore zeytare Dauti, pronar i së cilës jam”.*

50. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se: *“si rezultat i qëndrimeve tendencioze të manifestuara nga personat përgjegjës të organeve administrative të shkallës së parë, në dëmin tim, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit si dhe Gjykata Supreme, kanë miratuar vendime me të cilat e kanë favorizuar organin komunal, duke mos e shqyrtuar fare faktin se organi komunal me lëshimet e tija ma kanë pamundësuar lidhjen e kontratës për shfrytëzimin e ngastrës kadastrale, për ndërtimin e objekteve ose për legalizimin e tyre [...]”.*
51. Parashtruesi i kërkesës i *“propozon Gjykatës Kushtetuese që në bazë të shpalljes së aktvendimeve të organeve të shqyrtimit të Komunës së Mitrovicës së Jugut vlerësohen si shkelje e nenit 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje ose në kompensimin e dëmit për rrënimin pa të drejtë të objekteve afariste, pronar i të cilave kam qenë”.*

## **Dispozitat përkatëse kushtetuese**

### **Kushtetuta e Republikës së Kosovës**

#### **Neni 3 [Barazia para Ligjit]**

*“1. Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore.*

*2. Ushtrimi i autoritetit publik në Republikën e Kosovës bazohet në parimet e barazisë para ligjit të të gjithë individëve dhe në respektimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe në mbrojtjen e të drejtave dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre”.*

## **Pranueshmëria e kërkesës**

52. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
53. Në këtë drejtim, sipas paragrafit 1 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.*

*[...]*

*7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

54. Gjykata, po ashtu, i referohet nenit 47 (Kërkesat individuale) të Ligjit, i cili parasheh:

Neni 47  
(Kërkesa individuale)

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.  
2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.*

55. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij dhe përgjigjen e tij ndaj shkresës plotësuese të Gjykatës specifikon se e konteston “Njoftimin e Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Mitrovicës së Jugut” të 24 majit 2011, si dhe “Aktvendimin [05 nr. 354/86123] e Drejtorisë për Inspeksion të Komunës së Mitrovicës së Jugut, të 22 nëntorit 2016”. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se këto vendime administrative të autoriteteve komunale ishin objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit në procedurë para gjykatave të rregullta, procedurë e cila përfundoi me nxjerrjen e Aktgjykimit [Rev. nr. 106/2023] të Gjykatës Supreme të 24 majit 2023. Në këtë kuptim, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës i ka shteruar të gjitha mjetet juridike si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit, siç përcaktohet në rregullin 34 paragrafi (1) (b) dhe (c) të Rregullores së punës.
56. Megjithatë, Gjykata më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen në Ligj dhe në Rregullore të punës, respektivisht, nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit dhe rregullit 34 (1) (d) të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

Neni 48 i Ligjit  
(Saktësimi i kërkesës)

*“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*

Rregulli 34  
(Kriteret e pranueshmërisë)

*(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:  
[ ... ]*

*(d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese”.*

57. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se neni 48 i Ligjit përmban gjithsej dy kërkesa. E para konsiston në (i) obligimin e parashtruesve të kërkesës që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë se u janë cenuar nga autoriteti publik - vendimin e të cilit e kontestojnë; dhe, e dyta konsiston në (ii) obligimin e parashtruesve të kërkesës që të specifikojnë aktin konkret të autoritetit publik që dëshirojnë ta kontestojnë para Gjykatës Kushtetuese. Që të dy këto kriteret të nenit 48 të Ligjit, e veçanërisht kriteri i parë i këtij neni reflektohen edhe në rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës ku kërkohet që një kërkesë e parashtruar në Gjykatë duhet të qartësojë saktësisht dhe në mënyrë adekuate të paraqet



faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese (shih, rastet e Gjykatës, KI95/19, parashtrues *Ruzhdi Bejta*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafi 31; KI157/21, parashtrues *Nexhat Veseli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 10 nëntorit 2021, paragrafi 33; KI73/21, parashtruese *Minire Krasniqi-Zhitia*, Aktvendim për papranueshmëri, i 29 korrikut 2021, paragrafi 39; dhe KI91/17, parashtrues *Enver Islami*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 nëntorit 2018, paragrafi 31).

58. Gjykata, duke iu rikthyer rrethanave të rastit konkret, në kuptim të obligimit të parashtruesve të kërkesës për plotësimin e kriterëve të lartcekura të pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, thekson se parashtruesi i kërkesës në përgjigjen e tij ka specifikuar se cilat vendime të autoritetit publik ai i konteston, megjithatë i njëjti nuk ka saktësuar se cilat të drejta dhe liri, të garantuara përmes Kapitullit II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës atij i janë cenuar.
59. Gjykata ripërsëritë se parashtruesi i kërkesës pretendon vetëm shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit ] të Kushtetutës, si një nga dispozitat themelore të Kapitullit I të Kushtetutës, e cila (i) Republikën e Kosovës e përkufizon si shoqëri shumëetnike, e cila qeveriset në mënyrë demokratike në respektim të plotë të sundimit të ligjit përmes institucioneve të veta, legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore; (ii) ushtrimi i autoritetit publik bazohet në parimet e barazisë para ligjit, respektimit të plotë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe në mbrojtjen e të drejtave si dhe në pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.
60. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk ka arritur të saktësojë se cilat të drejta dhe liri themelore, të specifikuara në Kapitullin II të Kushtetutës, janë shkelur si rezultat i nxjerrjes së vendimeve të kontestuara të autoriteteve komunale dhe atyre gjyqësore.
61. Gjykata, në vijim, vëren se parashtruesi i kërkesës përmes kërkesës së tij të dorëzuar në Gjykatë nuk pajtohet me vendimet e autoriteteve komunale dhe atyre të gjykatave të rregullta, dhe se thelbi i pretendimeve të tij ndërlidhet me vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike dhe interpretimin e ligjit. Në lidhje me këtë të fundit, në kërkesën e tij, ai specifikon se: *“si rezultat i qëndrimeve tendencioze të manifestuara nga personat përgjegjës të organeve administrative të shkallës së parë, në dëmin tim, Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit si dhe Gjykata Supreme, kanë miratuar vendime me të cilat e kanë favorizuar organin komunal, duke mos e shqyrtuar fare faktin se organi komunal me lëshimet e tija ma kanë pamundësuar lidhjen e kontratës për shfrytëzimin e ngastrës kadastrale, për ndërtimin e objekteve ose për legalizimin e tyre [...]”*.
62. Në dritën e elaborimit si më sipër, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të qartësojë se cilat të drejta dhe liri të garantuar me Kushtetutë, i janë shkelur përmes vendimeve të kontestuara komunale, përfshirë këtu edhe Aktgjykimin e fundit të Gjykatës Supreme, të 24 majit 2023, dhe si e tillë kërkesa duhet të refuzohet për mosplotësimin e kriterëve të pranueshmërisë të parapara me nenin 48 të Ligjit në lidhje me rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës.
63. Si rrjedhojë, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullin 34 (1) (d) të Rregullores së punës, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtrueses së kërkesës duhet të deklarohet e papranueshme.

## PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 34 (1) (d) dhe 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 11 shtator 2024, njëzëri

## VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani